



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of Minister of Justice

Nr. 68 /2021
Datë: 07/04 /2021

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10, (paragrafi 1 dhe 2), dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr.7/01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8, (paragrafi 1, nën paragrafi 1.4) të Rregullores (QRK)-Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (30.03.2021), në përputhje me nenin 24/B (paragrafi 4) të Rregullores QRK-Nr. 12/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores QRK-Nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet vendimi nr. 81/2020, dt. 17.08.2020, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 22/2021, dt. 11.01.2021, me të cilin z. Sami Bunjaku është emëruar Zyrtar i Divizionit për koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Obligohet Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin nr. 81/2020, dt. 17.08.2020, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 22/2021, dt. 11.01.2021, z. Sami Bunjaku është emëruar Zyrtar i Divizionit për

koordinimin e procesit për mbrojtjen juridike dhe mbështetjen financiare të personave të akuzuar potencial në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.

Duke pas parasysh faktin se ky vendim është përtej rregullores përkatëse në fuqi dhe rrjedhimisht në kundërshtim me nenin 24/B (paragrafi 3) të Rregullores QRK-Nr. 12/2018 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores QRK-Nr. 31/2013 për organizimin e brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

Vendimi i dërgohet:

- Z. Sami Bunjaku;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm/MD;
- Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
Divizionit për KPMJMFAPPGjDhS/MD;
- Arkivit të MD-së.